

# RAPORT TEKNIK

“SISTEMIM-ASFALTIM I RRUGËS “MICJONE”, FSHATI  
BORIZANË, NJ.A.THUMANË, KRUGË”

PROJEKTUES: “ERALD-G” SH.P.K

## POZICIONI ORTHOFOTO



TIRANË 2024

## **HYRJE**

### **1-Te pergjithshme**

Thumana (përfshirë fshatin Borizanë) ndodhet rreth 32 km ne veri te qytetit të Tiranës. Shtrihet rreth kuotes 15m mbi nivelin e detit, eshte zone fushore e kodrinore, me pjerresi te terrenit 1.5-5% me drejtim lindje-perendim. Ne afersi te saj ka disa kodra te vogla me lartesi 80-120m mbi nivelin e detit.

Rritja e ritmeve te zhvillimit ne vendin tone, dhe atij turistik ne veçanti, kerkojne investime te vazhdueshme si per permiresimin e rrjetit rrugor ekzistues, po ashtu edhe te ndertimit te rrugeve te reja per t’iu pergjigjur trafikut gjithmone ne rritje.

Shoqeria projektuese (konsulente) “Erald-G”shpk ne baze te termave te references (detyres se projektimit), ka kryer studim-projektimin e kesaj rruge te re, ka kaluar te gjitha fazat sipas programit te hartuar, duke filluar nga:

- Projekt idea
- Takime ne Njesine Administrative Thumanë.



Projekti permban:

1. Studimin e Projekt Idese
2. Studimin e Ambjentit
3. Relacionin teknik qe permban nje pershkrim te pergjithshem per zonen, te dhena mbi gjendjen ekzistuese te rruges, pershkrimin mbi hartimin e projektit, llogaritjet e shtresave rrugore, llogaritjet konstruktive, etj.
4. Specifikimet teknike
5. Vizatimet e punes si: planimetrine e pergjitheshme te ndertimit, profilin gjatesor, profilat terthore tip, planimetrite e disiplinimit te ujrave, vizatimet konstruktive, te gjitha detajet dhe hollesite, etj.
6. Preventivin perfundimtar te ndertimit.

Si shoqeri konsulente per hartimin e projektit jemi bazuar tek standartet dhe kushtet teknike shqiptare (keto kushte teknike shtrihen ne studimin dhe projektimin e rrugeve

te reja dhe rindertimin e rrjetit rrugor egzistues te Republikes se Shqiperise). Per veprat e artit jemi bazuar ne kushtet teknike te projektimit per rruge te kategorise se pare.

## **2- FOTO TË GJËNDJES EKZISTUESE TË RRUGËS**





**Figura 2, Foto të gjëndjes ekzistuese**

### **3- KUSHTET KLIMATIKE DHE HIDROLOGJIKE**

#### **KUSHTET KLIMATIKE**

Hidrologjia e krahinës së Thumanës, varet së pari nga klima, së dyti nga topografia dhe gjeologjia. Faktorët klimatikë të një rëndësie parësore janë rreshjet dhe mënyra e perhapjes së tyre, lagështia, temperatura dhe era, të cilat ndikojnë në avullimin dhe transpirimin.

Faktorët klimatikë të cilët janë marrë në konsideratë në analizë përfshijnë:

- Temperatura e ajrit,
- reshjet dhe analiza e tyre,
- bora dhe
- era.

Të dhënat që mbështesin këtë analizë janë marrë nga vendmatjet të zgjedhur dhe janë përmbledhur në tabelën 2.1

Regjistrimet klimatike nga stacionet klimatologjike mund të konsiderohen përfaqësuese të kushteve të pritura në Thumanë. Statistika klimatike të publikuara për periudhën nga 1942 janë përmbledhur në tabele.

#### **POPULLSIA**

Të gjitha të dhënat mbi popullsinë e Thumanës (përfshirë fshatin Borizanë) u dhane nga ish komuna Thumanë dhe në detyrën e projektimit. Popullsia e Thumanës deri në vitin 2012 nga të dhënat e ish Komunes është 11000 banorë. Studiumi demografik japin të dhëna të përafërta me ato të ish bashkisë.

#### **EKONOMIA**

Thumana renditet në qendrat me një zhvillim të mirë ekonomik, tregtare të vendit. Jo vetëm fshati Borizanë e Nj.A.Thumanë, por i gjithë rrethi në teresi ka luajtur historikisht një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të krejt vendit.

Në këto zone janë të mundshme për t'u zhvilluar të gjitha aktivitetet ekonomike. Megjithatë midis tyre vlen të veçohen sektore të tilla si industria e prodhimit të inerteve, e mobilitetit, ekonomia bujqësore.

#### **- Rilevimi Topografik dhe Hartat Baze.**

Rilevimi topografik i nevojshëm është kryer me instrument GNSS (GPS). Matjet topografike janë realizuar me metodën e RTK kinematike në kohë reale e cila përdor dy marrësa ku baza vendoset në një pikë me koordinata të njohura merr sinjalin e përpunon dhe pastaj e transmeton me radio Roveri është i pajisur me një antenë radio, bën llogaritjen e

koordinatave dhe bëhet korigjimi Në rastin tone baza është stacioni i AlbCORS më i afërt, me anë të përdoruesit të krijuar nga ASIG jam lidhur me stacionin bazë duke shfrytëzuar rrjetin Wireless të aparatit celular për të filluar matjet minimalisht duhet pesë 5 satelitë dhe saktësia që ofron metoda RTK është 8 mm në Horizontalitet dhe 15 mm në Vertikalitet Sistemi koordinativ i përdorur është KRGjSh. Në vijim krijuam një folder të ri për punën tonë realizuam lidhjen me sistemin AlbCORS dhe kryem matjet duke marrë pikat sipas një rregulli me skajet e objekteve fillimisht në njërin kah dhe pastaj në kahun tjetër duke marrë të dhënat topografike për elementët kryesorë të terreni dhe elementët e tjerë të relievit. Çdo pikë e shoqëruam me kodin përkatës duke përdorur tastirën.

Pikat topografike do të vendosen gjatë procesit të piktimit. Ato janë kulla celiku me bazament ose shenjime në ndertime të perhershme. Nivelet e pikave topografike do të bazohen në të dhënat e rrjetit KRGjSh; afërsisht gjashtë do të vendosen në çdo kilometër katror në zonat e banuara dhe çdo 300-500m përgjatë rrugëve të hyrjeve.

Te gjitha hartat janë në formate elektronike bashkë me një palë kopje të riprodhueshme.

° Janë përcaktuar ndertimet e perhershme dhe të perkohshme, shkarkimi I ujërave të zeza , muret rrethuese, gardhet portat e hyrjeve, kufijtë e parcelave. Janë treguar objektet në ndërtim.

° Në planimetri janë dhënë tubat kryesore, pusetat e ujërave të zeza dhe pusetat e kontrollit të shtrira në sipërfaqen e tokës.

° Janë dhënë dhe përcaktuar linjat e Energjisë Elektrike, linjat e tensionit, shtyllat, transformatorët, lidhjet me banesat, ndricimi rrugor.

° Në punimet topografike janë hedhur rruget dhe kalimet, dallohen rruget e shtruara dhe gjurmët e tyre.

° Mbeturinat e ngurta janë trajtuar dhe tregohen vendodhjet e kazaneve të plehrave ose vendet e hedhjeve të mbeturinave.

Rrjeti telefonik do të tregohet dhe të përcaktohen linjat , kabinet telefonike etj.

Hartat e përdorura për hartimin e këtij projekti , janë në shk.1:500,1:1000,1:25000 dhe 1:10000. Në hartat baze të zonës në shkallën 1:1000 dhe 1:500 të siguruar nga “Erald-G” shpik është hedhur azhornimi i zonës me kuotat gjeodezike të zonës, ka azhornim të banesave të reja të ndërtuara në këto zone në 10 vitet e fundit.

Projekt-zbatimi është punuar mbi hartat e shkallës 1:500 dhe 1:2500 të marra nga DPKZHT .

## **B.SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E RRUGES.**

Ky objekt ka dy segmente (rrugë) që lidhen njëra me tjetrën:

Degëzimi 1 (Verilindje-Jugperendim), degëzimi 2 (Verilindje-Jugperendim).

Degëzimi 1, fillon pranë kryqëzimit të rrugës “Micjone” me aksin e vjetër nacional Fushë Krujë-Thumanë, përshkon një gjatësi prej 430 ml drejt verilindjes dhe përfundon në kryqëzimin e rrugës “Micjone” me kanalin e madh kullues dhe rrugën e lagjes “Hidri”, mbi urën ekzistuese.

Degëzimi 2, fillon në kryqëzimin e rrugës “Micjone” me rrugën “Hidri” mbi urën e kanalit kullues, përshkon një gjatësi prej 250 ml në drejtim të veriut dhe përfundon në kryqëzimin me rrugën e lagjes, pranë burimit natyral të ujit.

Rrugët përgjithësisht janë në gjendje të demtuar, demtime të cilat arrijnë deri në nenshtresa.

Janë rrugë të paasfaltuara më parë dhe me bazament përgjithësisht të qëndrueshëm.

Është parashikuar skarifikimi i rrugës nga mbeturinat e dherërat e këqija, mbushja me çakëll makinerie të pastër, shtrimi me stabilizant dhe realizimi i dy shtresave të reja sfaltike, binder 5cm dhe asfaltobeton 4cm. Gjithashtu është parashikuar edhe ndërtimi i mureve mbajtëse b/a dhe i veprave të artit.

Parametrat e rruges jane:

#### DEGËZIMI 1 (VERILINDJA):

- Numri i gjurmeve të kalimit, 1.
- Gjerësia e shtresës asfaltike 3.5m.
- Gjerësia e bankinave 2x0.25m.
- Gjerësia e trupit të rruges 4.0 m.
- Gjatësia 430ml.
- Shpejtësia e llogaritur e levizjes së mjeteve deri 30km/h.

#### DEGËZIMI 2 (VERIU):

- Numri i gjurmeve të kalimit, 1.
- Gjerësia e shtresës asfaltike 3.0m.
- Gjerësia e bankinave 2x0.25m.
- Gjerësia e trupit të rruges 4.0 m.
- Gjatësia 250ml.

-Gjithashtu ky objekt ka edhe vepra arti si tombino me tubo betoni d=400mm, kanale anësore, zgara metalike (kanalina) etj.

**PER GRUPIN E PROJEKTIMIT**

**“ERALD-G” SHPK**

**ADMINISTRATORI**

**ING.GËZIM ISLAMI**